

VENDIM
Nr.206, datë 21.2.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA PËRMIRËSIMI I UNAZËS
SË RE, NË BASHKINË E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga përmirësimi i Unazës së Re, në bashkinë e Tiranës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Tiranës dhe, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të bëhet regjistrimi i pasurisë 3 233 m² tokë arë, në emër të kësaj bashkie.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 3 233 m², të vlerësuar në shumën e përgjithshme 39 879 055 (tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 39 879 055 (tridhjetë e nëntë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Tiranës.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale në shumën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë të përballohet nga bashkia Tiranë.
 6. Pasuria me nr.306/147, vol:13, fq.110, e ndodhur në zonën kadastrale 3866, të likuidohet pas zgjidhjes së konfliktit të pronësisë dhe pas konfirmimit nga ZRPP-ja.
 7. Afati i përfundimit të shpronësimit është data 5.3.2008.
 8. Afati i përfundimit të punimeve në objektin “Përmirësimi i Unazës së Re”, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Tiranës.
 9. Ngarkohet Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 10. Ngarkohet bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE DHE VLERA NË LEKË SIPAS DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

RRUGA UNAZA E RE (AFËR DOGANËS)

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. Pas	Truall (m ²)	Cmimi (lekë)	Vlefte (lekë)
1	Shkëndije Llagami	3866	215/73	608	12335	7499680
2	Shkëndije Llagami	3866	215/49	760	12335	9374600
3	Shkëndije Llagami	3866	301/59	700	12335	8634500
4	Shkëndije Llagami	3866	301/183	700	12335	8634500
6	Njazi Shijaku	8210	7/259	270	12335	3330450
8	Zyhdi Saraçi	8210	7/271	160	12335	1973600
9	Pronari	3866	306/147	35	12335	431725
			Shuma	3233		
						Shuma 39 879 055